



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26 Prill 2021

Nr: 302

VENDIM

PËR LIRIM DHE EMËRIM TË ANËTARIT TË KZAZ NR. 56, QARKU FIER

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenin 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VËREN

Në bazë të nenit 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, janë kërkuar zëvendësime të anëtarëve në KZAZ-të si më poshtë:

Partia Socialiste e Shqipërisë, me shkresën nr. 4505 prot., datë 26.04.2021, ka kërkuar zëvendësimin e kryetarit të KZAZ nr.56, Qarku Fier.

Propozimi dhe kandidatura e paraqitur, plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të liroj nga detyra kryetarin e KZAZ nr.56, z.Bledar Stavri Ndoni, Qarku Fier.
2. Të emëroj kryetar të KZAZ nr.56, z.Dorjan Fejzi Spaho, Qarku Fier.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen e KQZ-së dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI

